



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM
Nr. 3/6, datë 29.12.2020

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Znj. Arta Marku**, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të caktohet prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Znj. Arta Marku, do të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, nga data 01.01.2021 - 31.03.2021.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, Znj. Marku do të paguhet me pagën e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
4. Të njoftohen për këtë vendim Znj. Arta Marku, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

